## 1. Informacione te pergjithshme mbi shoqerine TRIMED sh.p.k.

TRIMED sh.p.k. u themelua me 01/12/2004 dhe u regjistrua me 09/12/2004 si nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Shoqeria aktualisht ka tre (3) ortake me pjesemarrjet ne kapital si me poshte:

| | |
|---|---|
| 1. Endrit Hido | 50%, |
| 2. Gentiana Peshkatari | 10% |
| 3. Shani Peposhi | 40% |
| **Totali** | **100%** |

Vlera e kapitalit te shoqerise eshte 60,900,000 leke, dhe shoqeria administrohet me nje nivel drejtimi, nga Administratori i shoqerise.
Zyrat qendrore te shoqerise jane ne Autostraden Tirane – Durres, km 10, Zona Kadastrale 2105, Kashar. Numri mesatar vjteor i punonjesve te punesuar gjate vitit 2020 eshte 101 punonjes nders ne muajin dhjetor 2020 rzultojne te punesura 102 punonjes. (Viti 2019 : 98 punonjes).

**Objekti**
Aktiviteti kryesor i Shoqerise eshte Import – eksport tranzit, depo farmaceutike dhe perfaqesim ne fushat farmaceutike, prodhim – perpunim – konfeksionim dhe tregti te medikamenteve, materialeve mjekesore dhe aksesoreve te tyre, barnave, materialeve dentare e veterinare, higjenosanitare, barnave mjekesore popullore, dhe artikujve koszmetike dhe e te ngjashme.

## 2. Bazat e pergatitjes

Shoqeria i ka pergatitur pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 ne perputhje me Standardet Nderkombetar te Raportimit Financiar ("SNRF").

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF"), te publikuara nga Bordi Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

***Pajtueshmëria me SNRF***
Në përputhje me Ligjin Nr. 25, datë 10 maj 2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", pasqyrat financiare të shoqerise janë përgatitur bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

***Baza e matjes***
Pasqyrat finaciare jane pergatitur ne baze te kostos historike dhe jane paraqitur ne Lek shqiptar ("Lek"), e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise si rrjedhoje e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe te gjitha vlerat jane rrumbullakosur ne Lek, pervec aty ku shprehemi ndryshe.

**Parimi i vijimësisë**

Ekzistenca e Koronavirusit të ri (Covid-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe tashmë është përhapur përtej kufijve të Kinës duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi. Më tej, më 12 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e COVID-19 pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, Autoritetet Shqiptare zbatuan masa të shumta duke u përpjekur të përmbajnë përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantinat, urdhrat e strehimit dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, duke përfshirë edhe mbylljet. Këto masa, ndër të tjera, kanë kufizuar

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51812031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

rëndë veprimtarinë ekonomike në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht dhe mund të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në bizneset, si dhe ekonominë shqiptare dhe globale për një periudhë të panjohur kohore.
Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, meqenëse drejtuesit e shoqerise besojnë se shoqeria do të vijojë të paktën aktivitetet e saj administrative edhe gjatë vitit pasardhës.

## 3. Permbledhje e politikave me te rendesishme kontabel

Politikat e adoptuara te kontabilitetit jane ne perputhje me ato te vitit te kaluar financiar. Ndryshimet qe rrjedhin nga permiresimet ne SNRF nuk kane ndonje ndikim ne politikat kontabel, pozicionin financiar apo ne ecurine e Shoqerise.
**Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2020**, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek shoqeria:

- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar në 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në SNRF 3 "Përkufizimi i një biznesi" (publikuar në 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet e bëra për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020)
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

**Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara**

- Shitja ose kontributi i Aktiveve mes nje Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar në Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas nje date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata- Amendimi në SNK 1 (publikuar më 23 Janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqeria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

***Instrumentat Financiare***
Ne Korrik te vitit 2014, BSNK publikoi versionin perfundimtar te SNRF 9 Instrumentat Financiare qe zevendeson SNK 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja dhe te gjitha versionet e meparshme te SNRF 9. SNRF 9 bashkon te tre aspektet e kontabilitetit per projektin e instrumenteve financiare: klasifikimi dhe matja; renia ne vlere; dhe kontabiliteti mbrojtes. SNRF 9 do te hyje ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2018, me aplikim me te hershem te lejuar. Kerkohet

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

zbatimi retrospektiv perveçse per kontabilitetin mbrojtes, por nuk eshte i detyrueshem dhenia e informacionit krahasues. Per kontabilitetin mbrojtes, kerkesat aplikohen ne pergjithesi ne menyre prospektive, me disa perjashtime te kufizuara. Shoqeria ka ne plan te zbatoje standartin e ri ne daten qe hyn ne fuqi. Ne pergjithesi, Shoqeria nuk pret ndikim te rendesishem ne bilancin e saj dhe kapitalet e veta.
Standardet dhe interpretimet e leshuara, por ende nuk jane bere efektive, deri ne daten e leshimit te pasqyrave financiare te subjektit jane shtjelluar me poshte. Shoqeria do te zbatoje keto standarde, nese eshte e aplikueshme, kur ato hyjne ne fuqi.

*Klasifikimi dhe matja*
Shoqeria nuk pret nje ndikim te rendesishem ne bilancin e saj ose ne kapital nga aplikimi i klasifikimit dhe matjes sipas kerkesave te SNRF 9. Ajo parashikon qe te vazhdoje te beje matjen me vleren e drejte te gjitha aktivet financiare qe aktualisht mbahen me vleren e drejte.

*Zhvleresimi*
SNRF 9 kerkon qe shoqeria te regjistroje humbjet e pritshme te kredise te te gjitha letrave me vlere te borxhit te saj, huave dhe llogarive e arketueshme tregtare, ose mbi nje baze 12-mujore ose ne baze te jetes se tyre. Shoqeria parashikon qe te zbatoje qasjen e thjeshtuar dhe te njohe humbjet e pritshme ne te gjitha llogarive te arketueshme mbi bazen e jetes se tyre. Shoqeria nuk pret ndonje ndikim te rendesishem ne kapitalit te saj per shkak te natyres te huave te saj dhe llogarite e arketueshme, por mbase do te duhet nje analize me e detajuar ne kohen e duhur.

*Kontabiliteti mbrojtes*
Shoqeria nuk ka ndonje instrument te kontabilitetit mbrojtes dhe nuk pret nje ndikim te rendesishem si pasoje e aplikimit te SNRF 9. Shoqeria do te vleresoje ndryshimet e mundshme ne menyre me te detajuar ne te ardhmen.

## 3. Permbledhje e politikave me te rendesishme kontabel (vazhdim)
*(a) Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet ne fuqi qe nga 1 Janar 2018*

***SNRF 15 Te ardhurat nga kontratat me klientet***
SNRF 15 u botua ne Maj 2014 dhe krijon nje model pese-hapesh per te llogaritur te ardhurat qe rrjedhin nga kontratat me konsumatoret. Sipas SNRF 15, te ardhurat njihen ne nje vlere e cila pasqyron shumen per te cilen shoqeria ka te drejten e kembimit per transferimin e mallrave ose sherbimeve per te nje klient. Te ardhurat nga kontrata e klientit, te cilat me pare njiheshin gjate gjithe afatit te kontrates mund te njihen ne te ardhmen vetem nje here dhe ne total, ne perfundim te kontrates dhe anasjelltas. Parimi baze i SNRF 15 eshte se te ardhurat do te njihen ne momentin qe produktet dhe / ose sherbimet transferohen nen kontrollin e klientit.
Standardi i ri i te ardhurave do te zevendesoje te gjitha kerkesat aktuale per njohjen e te ardhurave sipas SNRF-ve. Per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2018 eshte e nevojshme ose nje aplikim i plote retrospektiv ose nje aplikim retrospektiv modifikuar. Zbatimi i hershem eshte i lejuar. Shoqeria ka ne plan te miratoje standardin e ri ne daten e hyrjes ne fuqi duke perdorur metoden e plote retrospektive

*Kryerja e sherbimeve*
Shoqeria ofron sherbime portuale, te cilat rregullohen me nje kuader ligjor te veçante. Disa nga keto sherbime ofrohen nepermjet paleve te treta koncesionare me te cilat ka nje kontrate dhe ne

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

shumicen e rasteve nuk ka sherbime te tjera te ofruara, perveç atyre te pershkruara ne kontrate, prandaj dhe zbatimi i ketij standarti nuk do kete ndonje efekt te pritshem.

*Prezantimi dhe kerkesat per dhenie informacione shpjeguese*

SNRF 15 kerkon dhenien e shpjegimeve plotesuese, te cilat jane me te hollesishme sesa sipas SNRF-se aktuale. Keto kerkesa paraqesin nje ndryshim te rendesishem nga praktika aktuale dhe ne menyre te konsiderueshme rrisin volumin e informacioneve shpjeguese te kerkuara ne pasqyrat financiare te njesise ekonomike. Shumica e kerkesave per dhenie informacionesh shpjeguese ne SNRF 15 jane krejtesisht te reja.

(b) Permiresime vjetore

Keto perfshijne:

- *Ndryshimet ne SNRF 4:*

Ndryshimet me te fundit perfshijne mundesine qe njesite ekonomike te cilat ofrojne kontrata sigurimi te perjashtohen nga zbatimi i SNRF 9. Gjithashtu, standarti perpiqet te adresoje disa shqetesime ne lidhje me veshtiresite qe mund te lindin per shkak te SNRF 9. Njesia ekonomike qe zgjedh te aplikoje perjashtimin, eshte e detyruar te jape informacion ne shenimet shpjeguese.

- *Ndryshimet* ne SNRF 2:

Per transaksionet e pagesave te bazuara ne aksione, ne te cilat mallrat ose sherbimet pranohen si pjese e marreveshjes se pageses se bazuar ne aksione, ndryshimet e fundit perfshijne disa modalitete te deklaratave financiare ne lidhje me metodat dhe mjetet qe do te perdoren per pagesat e bazuara ne aksione. Qellimi eshte te prezantohet udhezimi i kerkesave te kontabilitetit per pagesat e bazuara ne aksione te rregulluara ne mjete monetare qe ndjekin te njejten qasje qe perdoret per pagesat e bazuara ne aksione te rregulluara me kapital neto.

- *Ndryshimet ne SNK 40:*

Standardi ofron mundesine e njesise ekonomike per te transferuar nje aktiv ne ose nga nje pasuri afatgjate e investuar vetem kur ka nje ndryshim ne perdorim. Nje ndryshim ne perdorim ndodh kur nje prone ploteson ose pushon se permbushuri kriteret per te qene nje aktiv afatgjate investimi dhe kur ka prova te ndryshimit ne perdorim.

**3. Permbledhje e politikave me te rendesishme kontabel (vazhdim)**

(c) Standardet e reja, interpretimet dhe amendamente qe kane hyre ne fuqi kete vit (2019)

- *SNRF 16 Qirate*

SNRF 16 eshte botuar ne Janar 2016 dhe zevendeson SNK 17 Qirate, KIRFN 4 Percaktimi nese nje marreveshje permban nje qera, KIS-15 Masat nxitese te qerave te zakonshme dhe KIS-27 Vleresimi i permbajtjes se transaksioneve qe kane formen ligjore te nje qiraje. SNRF 16 percakton parimet per njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhenien e shenimeve shpjeguese te qirave dhe kerkon qiramarresit te japin llogari per te gjitha qirate nen nje model te bilanci te vetem te ngjashme me kontabilitetin e qirave financiare sipas SNK 17.

Standardi perfshin dy perjashtime te njohjes per qiramarresit; qirate e aktiveve "me vlere te ulet" (p.sh., kompjutera personale) dhe qirate afat-shkurter (p.sh., qirate me afat 12 muaj ose me pak). Ne daten e fillimit te qirase, qiramarresi do te njohe nje pasiv per te bere pagesat e qirase (dmth detyrim qiraje) dhe nje aset qe perfaqeson te drejten e perdorimit te aktivit themelor gjate afatit te qirase (p.sh., e

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51812031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

drejta e perdorimit te pasurise). Qiramarresi do te kerkohet te njohe veçmas shpenzimet e interesit mbi pasivin qirase dhe shpenzimet e amortizimit per aktivin qe ka marre me te drejte perdorimi.

Qiramarresit do ti linde nevoja e rimatjes se pasivit te qirase pas ndonje ngjarje te caktuar (p.sh., nje ndryshim ne afatin e qirase, nje ndryshim ne pagesat e ardhshme te qirase qe rezulton nga nje ndryshim ne nje indeks ose norme qe perdoret per te percaktuar keto pagesa). Qiramarresi ne pergjithesi do te njohe shumen e rimatur te detyrimit te qirase si nje rregullim ne vleren e aktivit me te drejte perdorimi.
Kontabiliteti per Qeradhenesin sipas SNRF 16 ngelet ne thelb i pandryshuar nga kontabiliteti qe parashikon SNK 17. Qeradhenesi do te vazhdoje te klasifikoje te gjitha qirate duke perdorur te njejtin parim klasifikimi si ne SNK 17 dhe te bejne dallimin midis dy llojeve te qirave: qira te zakonshme dhe te financave. SNRF 16 kerkon gjithashtu qe qiramarresit dhe qiradhenesit te bejne shenime shpjeguese me te gjera sesa ç'kerkohej sipas SNK 17. SNRF 16 eshte ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne ne daten 1 Janar 2019 ose me pas, dhe lejohet zbatimi i tij me i hershem, por jo para se shoqeria te zbatoje SNRF 15. Nje qiramarres mund te zgjedhe per te aplikuar kete standarde duke perdorur ose nje retrospektive te plote apo nje qasje te modifikuar retrospektive. Dispozitat kalimtare te standardit ofrojne disa lehtesira.

(e) Transaksionet ne monedhe te huaj
Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit rikonvertohen ne monedhe funksionale duke perdorur kursin e kembimit te publikuar nga Banka e Shqiperise ne ate date. Humbjet apo fitimet nga kursi i kembimit qe rezultojne nga keto transaksione si dhe nga rivleresimi i zerave monetare ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fundit te vitit njihen ne fitim ose ne humbje.
Zerat jo-monetare nuk rivleresohen ne fund te vitit dhe maten me koston historike (konvetorhen duke perdorur kursin e kembimit te dates se transaksionit), pervec zerave jo-monetare qe maten me vlere te drejte, te cilat konvertohen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e percaktimit te vleres se drejte.
Kurset kryesore te kembimit jane:

| | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| 1 EUR | 123.74 | 121.77 |
| 1 USD | 108.84 | 108.64 |

(f) Instrumentet financiare
Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative, qe perfshijne mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogari te arketueshme, llogari te pagueshme dhe hua.Instrumentet financiare jo-derivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervetesimin e tyre, perveç siç shpjegohet me poshte.Njohja ne vijim e instrumenteve financiare jo-derivative pershkruhet me poshte. Nje instrument financiar njihet ne rast se Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Shoqerise ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne, ose nese Shoqeria i transferon aktivin financiar nje pale tjeter, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivit.Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh.daten ne te cilen Shoqeria zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Shoqerise te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anulluar.

Aktivet Financiare

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

*Kredi dhe te tjera te arketueshme*
Kredi dhe te tjera te arketueshme jane aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme te cilat nuk jane te kuotuara ne tregje aktive perveç atyre aktiveve qe Shoqeria synon ti shese brenda nje periudhe afatshkurter ose i ka percaktuar si aktive me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes ose si te vlefshme per shitje.Kredite dhe te drejtat e tjera njihen ne fillim me vlere te drejte dhe ne vazhdim maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv minus provigjionin per zhvleresim. Provigjioni per zhvleresimin e kredive dhe te drejtave te tjera te arketueshme krijohet kur ka nje evidence objektive qe Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha shumat sipas kushteve fillestare.Te drejtat e arketueshme nga aktiviteti i sigurimit qe vijne nga mbajtesit e policave te sigurimit gjithashtu klasifikohen ne kete kategori dhe rishikohen per zhvleresim si pjese e rishikimit perzhvleresim te kredive dhe te drejtave te tjera te arketueshme.

## 3. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

*Investime financiare te mbajtura deri ne maturim*
Investime financiare te mbajtura deri ne maturim jane aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme perveç atyre qe permbushin perkufizimin e kredive dhe te tjera te arketueshme dhe per te cilat Shoqeria ka qellimin dhe mundesine per ti mbajtur ato deri ne maturim.Keto aktive njihen ne fillim me vlere te drejte dhe ne vazhdim maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv minus provigjionin per zhvleresim, nese ka. Nje provigjion per zhvleresimin e instrumenteve te borxhit te mbajtur deri ne maturim krijohet nese ka nje evidence objektive qe Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Investime financiare te mbajtura deri ne maturim perfshijne bono thesari te emetuara nga Banka e Shqiperise.

*Njohja dhe çregjistrimi*
Blerjet dhe shitjet e investimeve financiare njihen ne daten e tregtimit e cila eshte data kur Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese instrumentin. Aktivet financiare njihen ne fillim me vlere te drejte plus, kostot e transaksionit qe lidhen drejtperdrejte me blerjen e tyre ne rastin e te gjithe aktiveve financiare qe nuk mbahen me vlere te drejtepermes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare te mbajtura me vlere te drejtepermes fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlere te drejte, dhe kostot e transaksionit njihen ne te ardhura ose shpenzime.

Aktivet financiare çregjistrohen kur te drejtat kontraktuale per arketime nga instrumentet financiare kane skaduar ose jane transferuar dhe kur Shoqeria transferon te gjitha rreziqet dhe shperblimet e pronesise.

*Matja e mepasshme*
Aktivet financiare te vlefshme per shitje dhe aktivet financiare me vlere te drejtepermes fitimit ose humbjes mbahen me vlere te drejte. Kredite dhe te drejtat e tjera te arketueshme dhe aktivet e tjera te mbajtura deri ne maturim mbahen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Kompesimi i instrumenteve financiare*
Aktivet dhe detyrimet financiare raportohen te kompesuara ne pasqyren e konsoliduar te pozicionit financiar vetem kur ekziston nje e drejte ligjerisht e zbatueshme per te netuar shumat e njohura dhe ka nje qellim per t'i mbajtur ato mbi baze neto, ose te njohesh aktivin dhe te shlyesh detyrimin ne te njejten kohe.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

*Investime ne letra me vlere*

Investimet ne letra me vlere jane instrumente borxhi per te cilat Shoqeria ka qellimin dhe aftesine qe ti mbaje deri ne maturim dhe ti klasifikoje si aktive te mbajtura deri ne maturim. Investimet, te cilat kane pagesa fikse apo te percaktuara dhe te cilat mbahen deri ne maturim maten ne vijim me koston e amortizuar minus provigjionin perzhvleresim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marr ne konsiderate çdo zbritje ose prim ne blerje.

*Instrumente kapitali*

Instrumentet e kapitalit jane aktive financiare te cilat nuk kane nje çmim tregu ne nje treg aktiv dhe vlera e drejte e tyre nuk mund te matet ne menyre te besueshme prandaj maten me kosto.

*Depozita me afat*

Depozitat me afat jane klasifikuar si kredi dhe te drejta dhe mbahen me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvleresimi.

*Llogarite te arketueshme*

Llogarite e arketueshme nga aktiviteti krzesor dhe te arketueshme te tjera paraqiten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvleresimi.

**3. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)**

*Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne arke, llogari rrjedhese ne Banka, te tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere, dhe perdoren nga Shoqeria ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

*Detyrimet financiare*

Shoqeria i klasifikon detyrimet financiare ne kategorite vijuese: llogari te pagueshme dhe huamarrje.

*Llogarite e pagueshme*

Llogarite e pagueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas vleresohen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Huamarrja*

Huamarrja njihen fillimisht me vleren e drejte, pa perfshire kostot e transaksionit. Huate me pas vleresohen me koston e amortizuar: çdo diference midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vleres se shlyerjes se detyrimit, njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huase duke perdorur metoden e interesit efektiv. Huate klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me perjashtim ne rast se eniteti ka nje te drejte te pakushtezuar per te shtyre shlyerjen e detyrimit per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit kontabel.

*Kostot e huamarrjes*

Kostot e huamarrjes te cilat lehtesisht jane te lidhura me ndertimin, prodhimin apo blerjen e nje aktivi, i cili ka nevoje per nje kohe te gjate per tu vene ne perdorim sipas qellimit fillestar te perdorimit apo shitjes, i shtohen vleres se aktivit, deri ne momentin ne te cilin aktivi eshte gati per perdorim. Te ardhurat nga investimet qe fitohen gjate nje aktivi perkates, i zbritet kostos se kapitalizueshme te huamarrjes. Te gjitha kostot e tjera te huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

*Humbjet nga zhvleresimi*

Ne çdo date te pasqyres se te pozicionit financiar, Shoqeria vlereson nese ka prova objektive qe aktivet financiare ose nje grup i aktiveve financiare eshte zhvleresuar. Nje aktiv financiar ose grup aktivesh financiare zhvleresohet dhe humbjet nga zhvleresimi njihen vetem nese ekzistojne prova objektive te zhvleresimit si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivi (nje 'ngjarje humbje') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim ne flukset e ardhshme te vleresuara te aktivit financiar ose te nje grupi aktivesh financiare qe mund te vleresohet me besueshmeri.

Deshmi objektive qe nje aktiv financiar ose grup aktivesh eshte zhvleresuar perfshin te dhena te vezhgueshme qe vijne ne vemendjen e Shoqerise ne lidhje me ngjarjet e meposhtme:

a. Veshtiresi te konsiderueshme financiare te emetuesit ose te debitorit;
b. Shkelja e kontrates, si vonesa ne pagesa e penalitete;
c. Mundesia qe emetuesi ose debitori do te hyje ne proces falimentimi ose riorganizime te tjera financiare;
d. Zhdukja e nje tregu aktiv per aktivin financiar per shkak te veshtiresive financiare, ose
e. Te dhena te vezhgueshme qe tregojne se ka nje renie te matshme ne vleresimin e flukseve te ardhshme monetare nga nje grup i aktiveve financiare qe nga njohja fillestare e tyre, megjithese renia ende nuk mund te identifikohet specifikisht me nje aktiv financiar te Shoqerise, duke perfshire:
    - Ndryshimet jo te favorshme ne statusin e pageses se emetuesit ose te debitorit ne Shoqeri, ose
    - Kushte ekonomike kombetare apo lokale ekonomike qe lidhen me mos pagesen e aktivit te Shoqerise

**3. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)**

Ne fillim, Shoqeria konsideron nese ekzistojne evidenca objektive individuale te zhvleresimit per aktivet financiare dhe jane individualisht te konsiderueshme. Nese Shoqeria percakton se nuk ka evidenca objektive te zhvleresimit per nje aktiv financiar te testuar individualisht, i konsiderueshem apo jo, e bashkon aktivin ne nje grup aktivesh financiare me rrezik krediti te njejte dhe ne menyre kolektive i teston per zhvleresim. Aktivet qe jane te testuara ne menyre individuale dhe per te cilat nje humbje nga zhvleresimi ekziston ose vazhdon te njihet nuk bashkohen me aktivet e tjera qe testohen ne menyre kolektive.

Nese ekziston evidence objektive qe nje humbje nga zhvleresimi eshte krijuar per huate dhe te arketueshmet ose nga aktivet financiare te mbajtura deri ne maturitet qe mbahen me kosto te amortizuar, shuma e humbjes matet si diference midis vleres kontabel te aktivit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme monetare te vleresuara (duke perjashtuar humbjet e ardhshme te kredise qe kane ndodhur) te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit financiar. Vlera kontabel e aktivit zvogelohet nepermjet perdorimit te nje llogarie rezerve, dhe shuma e zhvleresimit njihet ne fitim ose humbje.

Nese nje investim i mbajtur deri ne maturim ose nje hua ka nje norme te ndryshueshme te interesit, norma e skontimit per matjen e zhvleresimit eshte norma aktuale efektive e interesit e percaktuar sipas kontrates.

Si praktike e njohur, Shoqeria mund te mase zhvleresimin e nje instrumenti financiar ne baze te vleres se drejte duke perdorur nje çmim te vezhguar te tregut.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TRIMED Sh.p.k. Nipt: K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

Per qellim te testimit kolektiv per zhvleresim, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave te ngjashme te rrezikut te kreditit (p.sh., ne baze te procesit te vleresimit te Shoqerise qe konsideron llojin e aktivit, industrine, pozicionin gjeografik, statusin e pagesave, dhe faktore te tjere te lidhur).
Keto karakteristika jane te rendesishme per vleresimin e flukseve monetare te ardhshme per grupe te tilla aktivesh duke qene tregues i aftesise se emetuesit per te paguar te gjitha shumat sipas kushteve kontraktuale te instrumentit te borxhit nen vleresim.
Ne qofte se ne nje periudhe te mevonshme, shuma e humbjes nga zhvleresimi zvogelohet dhe zvogelimi mund te lidhet objektivisht me ngjarje qe ndodhin pasi zhvleresimi ishte njohur (te tilla si permiresimi i indeksit te kreditit), humbja e njohur me pare nga zhvleresimi ndryshohet duke rregulluar llogarine e rezerves. Shuma e ndryshimit njihet ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese.

*Çrregjistrimi i instrumentave financiare*

Nje aktiv financiar çrregjistrohet pjeserisht ose totalisht ne rastin kur Shoqeria parashikon qe nuk do gjenerohen me flukse parash nga ky aktiv dhe nuk e ka me kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar te gjitha rreziqet dhe perfitimet qe lidhen me aktivin. Kur kemi te bejme me mosarketim nga klienti, ne rastin e llogarive te arketueshme, kryejme nje transferim te te gjitha risqeve dhe shperblimeve qe lidhen me pronesine, atehere kjo llogari klasifikohet per nje transferim, duke bere te mundur keshtu qe kjo llogari e arketueshme te jete e vlefshme per çrregjistrim, duke supozuar qe pagesa me vonese perben nje risk te parendesishem. Nje interpretim me i ngushte i konceptit te ‚transferim thelbesor i rreziqeve dhe perfitimeve' mund te vendose ne pikepyetje trajtimin kontabel qe eshte adoptuar.

(g) Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin dhe zhvleresimin e akumuluar, perveç tokes, e cila paraqitet me kosto minus zhvleresimin e akumuluar. Kosto perfshin shpenzime qe jane drejtperdrejt te ngarkueshme per blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve te ndertuara nga vete Shoqeria perfshin koston e materialeve dhe te fuqise punetore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet drejtperdrejt me venien e aktivit ne vendin dhe kushtet e nevojshme qe ai te jete i perdorshem ne menyren e synuar, dhe kostot e kapitalizuara te huamarrjes.
Kur pjese te nje elementi te aktiveve qendrueshme te trupezuara kane jetegjatesine e dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te veçanta. Drejtuesit kane aplikuar vleren e drejte si perjashtim per koston e supozuar ne lidhje me aktivet e qendrueshme te trupezuara, kur Shoqeria beri kalimin ne SNRF ne 1 Janar 2008. Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje aktivi te qendrueshem te trupezuar percaktohen duke krahasuar arketimet nga shitja me vleren kontabel neto te aktivit afatgjate material, dhe njihen ne fitim ose humbje.

Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhme qe i atribuohen atij elementi do t'i perkasin Shoqerise, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata mariale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vleren e amortizueshme, e cila eshte kostoja e mjetit, ose ndonje vlere tjeter qe perfaqeson koston, minus vleren e tij te mbetur.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

Toka dhe aktivet ne proces nuk amortizohen. Ndertesat, kalatat, sheshet dhe automekanizmat amortizohen sipas metodes se vleres se mbetur me normen 5%. Makinerite dhe pajisjet amortizohen sipas metodes se vleres se mbetur me 20%. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohet ne çdo date raportimi dhe rregullohen nese eshte e nevojshme.
Pajisjet e zyres amortizohen sipas metodes se vleres se mbetur me normen 20% dhe pajisjet informatike amortizohen sipas metodes se vleres se mbetur me 25%.

(gj) Aktivet afatgjata jo-materiale
Aktivet afatgjata jo-materiale, te cilat kane nje jete te dobishme te kufizuar, vleresohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimet e akumuluara. Norma e amortizimit eshte 10%-20% bazuar ne koston e aktivit.
Shpenzimet e mepasshme
Shpenzimet e mepasshme kapitalizohen vetem nese shpenzimi rrit perfitimet e arteston teston dhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin me te cilin ka te beje shpenzimi. Te gjitha shpenzimet, duke perfshire shpenzime per emrin e mire te gjeneruar nga Shoqeria apo markat, njihen ne te ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi
Amortizimi njihet ne pasqyren e gjitheperfshirese te te ardhurave bazuar ne vleren e mbetur duke perdorur normat fiskale per amortizimin e aktiveve te patrupezuara, nje muaj pas blerjes se aktivit.
Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe behen rregullimet e nevojshme, ne çdo date bilanci. Fitimet dhe humbjet nga shitja percaktohen duke krahasuar shitjet me vleren e mbetur dhe diferencat perfshihen ne pasqyren e gjitheperfshirese te te ardhurave.

(h) Inventari
Inventaret maten me vleren me te ulet te kostos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus kostot e vleresuara per perfundimin dhe realizimin e shitjes.
Kostoja e inventarit perfshin shpenzimet per blerjen e inventareve, kostot e prodhimit ose shnderrimit dhe kosto te tjera te nevojshme per sjelljen e tyre ne vendndodhjen dhe kushtet aktuale.

(i) Zhvleresimi
Aktivet financiare
Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes vleresohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka evidence objektive zhvleresimi. Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese nje evidence objektive tregon se ka ndodhur nje ngjarje zhvleresimi pas njohjes fillestare te aktivit, dhe kjo ka patur nje ndikim negativ ne flukset e çmuara te ardhshme te mjeteve monetare te aktivit financiar, i cili mund te vleresohet me besueshmeri.
Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diference ndermjet vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te mjeteve monetare, aktualizuar me normen fillestare te interesit efektiv.
Aktivet financiare te cilat jane te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohet bashkarisht ne grupe qe mbartin karakteristika te ngjashme risku. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Nje humbje zhvleresimi mund te anullohet nese ulja ne zhvleresim ka ndodhur per shkak te nje ngjarjeje qe ka ndodhur pasi eshte njohur zhvleresimi. Anullimi njihet ne fitim ose humbje.

Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J KOMPANI FARMACEUTIKE 1 TIRANE - ALBANIA

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise, perveç inventareve dhe aktiveve tatimore te shtyra, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka evidenca per zhvleresim. Nese ka evidenca te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvleresimi njihen nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Njesisa gjeneruese e mjeteve monetare eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse monetare qe jane te pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Aktivet jo-financiare

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi ose enjesise gjeneruese te mjeteve monetare eshte me e madhja ndermjet çmimit neto te shitjes dhe vleres se tij ne perdorim. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e çmuara te ardhshme te mjeteve monetare jane aktualizuar duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregjeve per vleren ne kohe te parase dhe risqet specifike per aktivin.

Persa i perket aktiveve te tjera, nje humbje per zhvleresim anullohet nese ka evidence se nuk ka zhvleresim, dhe ka patur ndryshim ne vleresimet e perdorura per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Humbja nga zhvleresimi anullohet deri ne ate mase sa vlera kontabel e aktivit nuk tejkalon vleren kontabel qe do te percaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur te mos ishte njohur ndonje humbje nga zhvleresimi.

(j) Provizionet

Provizione njihen nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme, per te cilin do te kerkohen flukse dalese parash per ta shlyer. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet specifike te detyrimit.

Provizionet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk eshte me e mundur qe te kete dajle burimesh ekonomike per te shlyer detyrimin, provizionet anullohen. Provizionet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht. Provizionet nuk njihen per humbje te ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e mundshme nuk njihen.

(k) Perfitimet e punonjesve

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Qeveria Shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Shoqeria nuk operon me ndonje skeme tjeter pensioni ose plan perfitimesh pas pensioni.

(l) Qirate

Percaktimi nese nje marreveshje eshte apo permban nje qira bazohet ne thelbin ekonomik te marreveshjes dhe kerkon nje vleresim nese permbushja e marreveshjes varet nga perdorimi i nje aktivi apo i disa aktiveve te veçanta dhe marreveshja kalon te drejten e perdorimit te aktivit.

Qirate financiare te cilat transferojne te gjitha rreziqet dhe perfitimet si pasoje e pronesise se aktivit te marre me qira, kapitalizohen ne fillim te qirase me vleren e drejte te prones qe merret me qira ose, kur eshte me e vogel, me vleren aktuale te pagesave minimale te qirase dhe perfshihen ne aktive afatgjata materiale me detyrimin perkates ndaj qiradhenesit te perfshire ne detyrime te qirase financiare. Pagesat e qirase ndahen midis shpenzimit financiar dhe reduktimit te detyrimit.

Aktivet e kapitalizuara amortizohen pergjate me te shkurtres midis jetes se tyre te dobishme dhe afatit te qirase ne rast se Grupi nuk perfiton pronesine ligjore te aktivit ne fund te periudhes se qirase.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

Pagesat e qirase se zakonshme njihen ne pasqyren e konsoliduar te pozicionit financiar. Qiraja e pagueshme kontabilizohet ne menyre lineare pergjate afatit te qirase dhe perfshihet ne 'Shpenzime te tjera operative'. Kur nje qira e zakonshme perfundon para afatit te percaktuar, çdo pagese qe eshte e detyrueshme ti behet qiradhenesit ne forme penaliteti njihet si shpenzim ne periudhen kur perfundimi ndodh.

**3. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)**

(ll) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfaqesojne hyrjen e perfitimeve ekonomike bruto pergjate rrjedhjes normale te biznesit. kur keto hyrje rezultojne ne rritje te kapitalit, ndryshe nga rritjet qe vijne si kontribute te aksionereve. Te ardhurat pvrfaqesojne vleren e drejte te hyrjeve apo te llogarive te arketueshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve, ne rrjedhen normale te biznesit. Te ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vleren e shtuar, kthimet apo skontot pasi jane eleminuar shitjet brenda Shoqerise, nese ka. Te ardhurat nga sherbimet njihen ne kohen qe sherbimi ofrohet. Te ardhurat nga sherbimet njihen ne periudhen kontabile qe sherbimi ofrohet duke i'u referuar fazes se realizimit te transaksionit, bazuar ne vleresimin e sherbimit te realizuar aktualisht ne lidhje me totalin e sherbimit qe do te ofrohet. E ardhura nga qiraja e ambjenteve te dhena me qira njihet ne fitim ose humbje ne baze lineare gjate kohes se qirase. Pagesat e motivimit te dhena, njihen si pjese perberese e te ardhurave totale nga qiraja gjate kohes se qirase.

(m) Shperndarja e dividentit

Shperndarja e dividentit aksionereve te Shoqerise njihet si detyrim ne periudhen ne te cilen dividentet jane aprovuar nga aksioneret e Shoqerise.

(n) Grantet qeveritare

Nje grant qeveritar i pakushtezuar i cili lidhet me dhurimin e paisjeve njihet fillimisht si e ardhur e shtyre me vleren e drejte kur ka siguri te arsyeshme qe do te merret dhe Shoqeria ka plotesuar kerkesat e donatorit. Grantet qe kompensojne Shoqerine per kosto te aktiveve njihen ne fitim ose humbje ne menyre sistematike bazuar ne jetegjatesine e aktivit. Grantet qe kompensojne Shoqerine per shpenzime te kryera, njihen ne fitim ose humbje si te ardhura te tjera ne menyre sistematike ne te njejten periudhe ne te cilen eshte kryer shpenzimi.

(o) Te ardhura dhe shpenzimet e interesit

Te ardhurat nga interesi perfshijne interesin e arketueshem nga fondet e investuara dhe njihet kur ai perfitohet duke perdorur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem te kredive. Kostot e huamarrjes qe nuk jane direkt te atribueshme per blerjen, ndertimin apo prodhimin e nje aktivi te percaktuar njihen ne fitim ose humbje permes metodes se interesit efektiv.

(p) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje perveç pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese. Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme. Tatimi i shtyre eshte njohur per diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt: K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit te mund te perdoren humbjet tatimore te paperdorura dhe kreditimet tatimore te paperdorura. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal.

(q) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqerise eshte i njohur me vlere nominale. Aksionet e zakonshme te shoqerise klasifikohet si kapital.

Shoqeria ka pergatitur pasqyrat financiare ne perputhje me SNRF-te e aplikueshme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 , se bashku me te dhenat per periudhen krahasuese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019, siç eshte pershkruar ne permbledhjen e politikave kontabel te rendesishme.

Qe nga viti 2014 shoqeria TRIMED shpk ka investuar duke blere 20% te aksioneve (ne vleren Lek 6,000,000) ne shoqerine 3P Life Logistic shpk e cila eshte formuar ne vitin 2014 me nje kapital fillestar prej Lek 30,000,000.

Ne perputhje me SNRF-te, shoqerise TRIMED shpk duhet te kontabilizoje Investimin e saj ne Pjesemarrje sipas metodes se kapitalit duke kontabilizuar fitim/humbjet nga pjesemarrja ne periudhen e realizimit te fitim/humbjeve nga kompania e investuar.

## 4. Mjete monetare dhe te ngjashme

Mjetet monetare dhe te ngjashme deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 paraqiten si me poshte:

| Nr | Emertimi | Nr llog. | Gjendje 31.12.2020 | Gjendje 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Vlera monetare ne banke** | 512 | 35,492,580 | 18,748,996 |
| | - Vlera monetare, ne leke | 5121 | 32,329,171 | 14,425,545 |
| | - Vlera monetare , ne monedha te huaja | 5124 | 3,163,409 | 4,323,451 |

Gjendja bankave paraqiten si me siper. Gjendjet e llogarive dhe depozitave ne EUR dhe USD jane pasqyruar ne lek duke perdoruar kursin e fundit te viteve respektivisht per 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019.

## 5. Te drejta te arketueshme neto (kliente)

Te drejtat e arketueshme deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 jane si me poshte:

| Të drejta të arkëtueshme | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të drejta nga klientë | 365,032,731 | 371,958,554 |
| Parapagime te dhena | - | - |
| Provigjon per borxhin e keq | (26,833,267) | (26,833,267) |
| **Totali** | **338,199,464** | **345,125,287** |

Te drejta te arketueshme jane pa interes dhe perbehen nga te arketueshme qe kane mosha nga me te ndryshmet, si kliente qe priten te arketohen brenda 30 diteve, 60 diteve, 90 diteve dhe pertej 120 diteve. Gjithashtu ka dhe kliente te cilat rezultojne te pashlyer prej me shume se 5 vitesh por edhe prej 10 vjetesh. Per llogarite e arketueshme eshte llogaritur provizion vetem per 2018.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

## 6. Te arketueshme te tjera (dividend nga pjesemarrjet)

| Të arketueshme te tjera (dividend nga pjesemarrjet) | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të arketueshme te tjera (dividend per tu arketuar nga 3Plife Logistic Shpk) | 21,826,842 | - |
| **Totali** | **21,826,842** | - |

## 7. Parapagime

| Parapagime | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Parapagime - Debitore te tjere (Furnitore debitor) | 5,083,030 | 1,000,492 |
| **Totali** | **5,083,030** | **1,000,492** |

Parapagimet jane bere per porosi te ndryshme malli kundrejt furnitoreve te huaj sipas klauzolave te rena dakord sipas porosive te shoqerise TRIMED shpk.

## 8. Te drejta te tjera per tu arketuar

| Te drejta te tjera per tu arketuar | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Tvsh e zbritshme | 585,682 | 3,406,921 |
| Debitore te ndryshem | 21,352,143 | 7,497,532 |
| **Totali** | **21,937,825** | **10,904,453** |

Aktive te tjera afatshkurtra perbehen kryesisht nga debitor te ndryshem dhe TVSH e e zbritshme respektivisht sipas balancave te mesiperme.

## 9. Inventari

Inventari deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 jane si me poshte:

| Inventari | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Materiale (inventari i imet) | 8,353,115 | 6,164,724 |
| Mallra vlera bruto | 994,419,316 | 914,255,910 |
| Zhvlersim i mallrave | (46,719,525) | (34,538,392) |
| Parapagime për inventar | - | - |
| **Totali** | **956,052,905** | **885,882,242** |

Inventaret maten me shumen me te vogel midis kostos dhe vleres se realizueshme neto. Kostoja e inventareve bazohet ne parimin e kostos mesatare dhe perfshin shpenzime te ndodhura ne blerjen e inventareve, kostot e prodhimit dhe te transformimit dhe kosto te tjera te ndodhura gjate transferimit dhe kondidat ekzistuese.

Ne rastin e inventareve te prodhuar dhe punimeve ne proces, kostoja perfshin nje shperndarje te caktuar te shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit duke u bazuar ne kapacitetin normal te aktivitetit. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit ne menuren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda"mesatares se ponderuar'.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

## 10. Aktive te Shtyra (Shpenzime te periudhave te ardhshme)

| Aktive te shtyra (Shpenzime te periudhave te ardhshme ) | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhshme | 1,979,068 | 1,745,220 |
| **Totali** | **1,979,068** | **1,745,220** |

## 11. Investim ne pjesemarrje

Investimi ne pjesemarrje e shoqerise TRIMED shpk deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 jane si me poshte:

| Investime ne pjesemarrje | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Pjesmarrje 20 % me kapitalin e shoqerise 3P Life Logistic Sh.p.k | 26,235,308 | 61,928,161 |
| **Totali** | **26,235,308** | **61,928,161** |

Prej vitit 2014 Shoqeria TRIMED shpk ka invesuar ne vleren Lek 6,000,000 duke blere 20% te aksioneve te shoqerise 3P Life Logistic shpk.

Sipas SNRF, specifikisht SNK 28 "Investime ne pjesemarrje" shoqeria TRIMED shpk duhet te kontabilizoje Investimin e saj ne pjesemarrje sipas metodes se kapitalit neto, duke pasqyruar fitim/humbjet e shoqerise se investuar ne te njejten periudhe ne menyre proporcionale ne pasqyrat financiare te saj. Pasqyrimi i rezultateve te shoqerise se Investuar 3P Life Logistic shpk eshte njohur direkt ne vleren e Investimit te pjesemarrje, duke njohur kundravleren ne fitimin e pashperndare te shoqerise TRIMED shpk per te gjitha vitet e Investimit dhe ne te ardhurat gjitheperfshirese ne vitin 2020.

## 12. Aktivet afatgjata materiale

Te gjitha aktivet e qendrueshme te trupezuara paraqiten me kosto pakesuar me pas me zhvleresimin dhe renien ne vlere nese ka zhvleresim. Kostoja perfshin shpenzimet te cilat lidhen drejteperdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete /ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes se drejteperdrejte cdo kosto theter lidhur direkt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per perdorimin e synuar dhe dhe kostot e cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivit. Drejtimi ka aplikuar vleren e drejte si baze per koston e supozuar per disa zera te aktiveve te qendrueshme te trupezuara

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TRIMED Sh.p.k. Nipt: K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

## Aktivet Afatgjata Materiale

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne date 31.12.2020

| Emertimi | Toka ,terrene, troje | Ndertim.Instali me pergjithshme | Instalime teknike Makineri Pajisje | Mjete transporti | Pajisje informatike | Pajisje zyre dhe orendi | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Aktive te Trupezuara* | | | | | | | |
| **Gjendje 31.12.2019** | **-** | **-** | **38,996,435** | **69,540,935** | **15,428,163** | **16,169,484** | **140,135,017** |
| Shtesa | - | - | 3,954,721 | - | 2,550,457 | 2,480,318 | 8,985,496 |
| Pakesime | - | - | - | 170,000 | - | - | 170,000 |
| **Gjendje 31.12.2020** | **-** | **-** | **42,951,156** | **69,370,935** | **17,978,620** | **18,649,802** | **148,950,513** |
| *Amortizimi* | | | | | | | |
| **Gjendje ne 31.12.2019** | **-** | **-** | **(14,944,711)** | **(25,138,558)** | **(5,158,620)** | **(6,488,641)** | **(51,730,530)** |
| Shtesa llogaritur | - | - | (5,219,011) | (8,877,654) | (2,912,596) | (2,134,506) | **(19,143,767)** |
| Pakesime | - | - | - | 122,031 | - | - | **122,031** |
| **Gjendje ne 31.12.2020** | **-** | **-** | **(20,163,722)** | **(33,894,181)** | **(8,071,216)** | **(8,623,147)** | **(70,752,266)** |
| | | | | | | | |
| ***Vlera neto 31.12.2019*** | **-** | **-** | ***24,051,724*** | ***44,402,377*** | ***10,269,543*** | ***9,680,843*** | ***88,404,487*** |
| ***Vlera neto 31.12.2020*** | **-** | **-** | ***22,787,434*** | ***35,476,754*** | ***9,907,404*** | ***10,026,655*** | ***78,198,247*** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

Kosto e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve te qendrueshme te trupezuare njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te kete perfitime te ardhshme ekonomike nga pjesa zevendesuese dhe kosto e saj mund te matet ne menyre te besueshme.

### 13. Huate nga institucionet financiare

| Huatë nga institucionet financiare | | |
|---|---|---|
| *Detyrim afatshkurter* | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
| Principal i pagueshem | 129,319,445 | 60,449,633 |
| Kosto financiare të shtyra | - | |
| **Totali** | **129,319,445** | **60,449,633** |

Huate e marra jane Overdrafte per qellime te kapitalit punues. Detajet per Overdraftet jane si me poshte:

| Kredi afatshkurter / Overdraftet | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| OTP (Societa general Alb) | 69,609,455 | 25,932,719 |
| Procredit Bank | 59,709,990 | - |
| ABI BANK | - | 34,516,914 |
| **Totali** | **129,319,445** | **60,449,633** |

Overdraft ne OTP Bank me kontrate nr 2280 rep nr 192/2 kol date 18.09.2019 eshte ne formen e leter garanci dhe leter kredi bankare, me afat 12 mujor me te drejte riperteritje dhe limitiim deri ne EUR 1.2 milion. Kredia jepet mje nje norem interesi e cila llogaritet me normen e interesit ne masen Bono thesari 12 M plus marzhin prej 1.5 % ne vit minimumi 3.7 % ne vit ne leke dhe LIBOR EUR 12M ( norma baze e interesit e publikuar ne faqen LIBOR te REUETRS ne daten e rinovimit te kredsie Kufi) plus marzhin prej 3% ne vit , minimumi 3% ne vit ne EURO .

Linje kredie me Procredit Bank date 24.04.2020, deri ne shumen 500 000 euro me afat 12 mujor , interesi i aplikuar caktohte 4 % ne vit dhe norma efektive e interesit e aplikuar do te jete 4.6 %. Shoqeria "Trimed" shpk ka lene peng makina (autovetura etj) sipas listes te evidentuar ne kontraten e kredise .

### 14. Arketime ne avance per porosi

Arketime ne avance per porosi me deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

| Arketime ne avance per porosi | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Te ardhura te periudhave te ardhshme | 30,690,573 | 30,690,573 |
| Parapagimet e marra per porosi (<12 muaj) | - | 596,663 |
| **Totali** | **30,690,573** | **31,287,236** |

Arketimet ne avance perfaqson vlera te arketuara paradhenie nga furnitoret sikunder vlere e mallit qe duhej kthyer ne origjine tek furnitori bazuar ne kontraten e lidhur mids paleve .

### 15. Furnitore

Furnitore me deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 dhe perbehen si me poshte:

| Furnitorë dhe të tjera detyrime | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Furnitor per mallra, produkte e sherbime | 520,228,958 | 539,005,226 |
| **Totali** | **520,228,958** | **539,005,226** |

Furnitoret perbehen nga llogari te pagueshme tregtare kryesisht per blerjet nga importi si dhe per blerjet brenda vendit. Llogarite e pagueshme kane maturitete te ndryshme nga te pagueshme deri ne 30 dite, 90 dite, deri ne 1 vit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA 1

### 16. Detyrime ndaj ortakeve

Detyrime ndaj Ortakeve deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

| **Detyrime ndaj ortakeve** | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Te drejta e detyrime ndaj ortakeve | 2,668,679 | 2,627,042 |
| Dividente per tu paguar ortakeve | 37,150,699 | 96,507,399 |
| **Totali** | **39,819,378** | **99,134,441** |

Detyrime ndaj ortakeve perbehet nga kryesisht nga dividentet per tu paguar. Ne 2019 shuma prej Lek 110 235 433 eshte deklaruar per tu paguar si dividente. Detyrimet tatimore jane paguar per kete shume, pjesa ndaj ortakeve ka mbetur per tu paguar.

### 17. Detyrime personeli dhe Sigurime Shoqerore

Detyrime per personelin dhe tatimore deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

| ***Te pagueshme ndaj punonjesve*** | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | 6,547,294 | 5,951,363 |
| Sigurimet Shoqerore dhe Shendetsore | 2,792,390 | 2,541,912 |
| ***Totali*** | **9,339,684** | **8,493,275** |

### 18. Detyrime tatimore

| ***Detyrime tatimore*** | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 1,329,360 | 1,248,577 |
| Tatim mbi fitimin | 1,661,992 | 3,092,938 |
| Tatimi ne burim | - | - |
| ***Totali*** | **2,991,352** | **4,341,515** |

Detyrimet tatimore perbehen si me siper. Keto shuma jane likujduar ne muajt e pare te vitit 2020.

### 19. Detyrime te tjera te pagueshme

Te tjera te pagueshme deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

| **Detyrime te tjera te pagueshme** | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Debitore, kreditore te tjere (< 12 muaj) | 17,370,749 | 13,548,839 |
| Parapagim | 1,134,023 | - |
| **Totali** | **18,504,772** | **13,548,839** |

Te tjera te pagueshme perbehen kryesisht nga detyrime ndaj perosnave te trete garanci te ndryshme tregtare per zbatimin e kontratave dhe llogari te ndryshme jo tregtare, te cilat jane te trasheguara nga viti i meparshem.

## 20. Detyrime te treteve (Financime Ortake)

Detyrimet ndaj te treteve (Ortakeve) deri me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 , perbehen si me poshte:

| Detyrime ndaj ortakeve | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve (>12 muaj) | 416,755,879 | 416,755,879 |
| **Totali** | **416,755,879** | **416,755,879** |

Detyrimet ndaj Ortakeve jane Hua te mundesuara nga ortaket aktual dhe ish ortakeve te shoqerise, te cilat kane sherbyer per te mundesuar investime dhe nevoja financiare te shoqerise. Keto shuma jane paraqitur ne detyrimet afatgjata sepse shlyrja e tyre do te jete me nje afat me shume se 5 vjecar, bazuar ne kontraten e lidhur ndermjet shoqerise dhe ortakeve aktual dhe ish ortakeve te shoqerise . Sipas kontrates kjo hua ka nje norme interesi vjetore 5.5% e pandryshueshme deri ne fund te afatit te shlyerjes.

## 21. Kapitali aksionar

### Numri dhe vlera nominale e aksioneve te regjistruara me 31 dhjetor 2020

Me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqerise eshte ne vleren Lek 60 900 000 dhe Lek 60 900 000 (2020), Lek 60 900 000 (2019).

Tabela e meposhtme paraqet pozicionin e Ortakeve te te shoqerise TRIMED sh.p.k. dhe kontributet e kryera me 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019 :

| Ortaket /aksionaret | % Kuotave | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|---|
| Endrit Hido | 50% | 30 450 000 | 30 450 000 |
| Shani Peposhi | 40% | 24 360 000 | 24 360 000 |
| Gentiana Peshkatari | 10% | 6 090 000 | 6 090 000 |
| **Totali** | **100%** | **60 900 000** | **60 900 000** |

- **Rezerva ligjore e kapitalit**

| Rezerva Ligjore dhe Statutore | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Rezerva ligjore | 3 548 609 | 3 548 609 |
| **Totali** | **3 548 609** | **3 548 609** |

Rezervat ligjore jane llogaritur duke u bazuar ne statutin e shoqerise dhe gjithashtu ne Ligjin per shoqerite tregtare.

## 22. Te ardhura nga aktiviteti

| Të ardhurat nga Aktiviteti | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga shitja mallrave | 2,301,411,268 | 2,283,841,568 |
| Të ardhura nga shërbimet | - | - |
| ***Totali*** | **2,301,411,268** | **2,283,841,568** |

Te gjitha te ardhurat nga aktiviteti kryesor jane te ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve qe tregrohen sipas objektit te shoqerise si psh produkte farmaceutike, prodhim – perpunim – konfeksionim dhe tregti te medikamenteve, materialeve mjekesore dhe aksesoreve te tyre, barnave, materialeve dentare e veterinare, higjenosanitare, barnave mjekesore popullore, dhe artikujve koszmetike.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt: K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

## 23. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Te ardhurat e tjera te shfrytezimit perbehen nga:

| Te ardhura te tjera te shfrytezimit | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Te ardhura te tjera | 189,375,228 | 101,004,915 |
| ***Totali*** | **189,375,228** | **101,004,915** |

Te ardhurat e tjera te shfrytezimit jane credit – note qe shoqeria realizon nga porosite dhe blerjet qe kryen me furnitoret e huaj, si dhe te ardhura te tjera te shoqerise. Normalisht keto shuma te kredit notave realizohen pas kryerjes se volumeve tregtare nga shoqeria me furnitoret e huaj.

## 24. Lende e Pare dhe materiale te konsumueshme

| Lenda e pare dhe materiale te tjera te konsumueshme | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | (1,988,352,947) | (1,922,360,929) |
| Te tjera shpenzime | (16,273,478) | (17,976,098) |
| ***Totali*** | **(2,004,626,425)** | **(1,940,337,027)** |

Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme perbehen nga gjithe blerjet e mallrave dhe produkteve qe tregtohen brenda vendit.

## 25. Shpenzime personeli

| Shpenzime te personelit | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | (95,329,278) | (85,228,035) |
| Sigurime shoqerore e shendetsore | (14,332,451) | (12,756,609) |
| ***Totali*** | **(109,661,729)** | **(97,984,644)** |

Personeli i shoqerise eshte i deklaruar me kohe te plote dhe per to jane llogaritur te gjitha detyrimet ne lidhje me sigurimet e tatimet pergjate gjithe vitit 2019.

## 26. Zhvlersimi Inventarit

| Zhvlersimi Inventarit | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Zhvleresimi i mllrave dhe materialeve te konsumueshme | (29,422,295) | (17,119,128) |
| ***Totali*** | **(29,422,295)** | **(17,119,128)** |

Zhvleresimi i inventareve eshte bere pas inventarizimit fizik te tyre dhe identifikimit te produkteve te demtuara, te zhvleresuar jashte funksionit te tyre. Shoqeria ka perllogaritur shumat e mesiperme te zhvleresimit duke reduktuar Inventarin ne vleren neto te realizueshme.

## 27. Amortizimi dhe zhvleresimi i aktiveve afatgjate

| Shpenzime dhe konsumi dhe amortizimi | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Konsumi/amortizimi i aktiveve afatgjata | (19,143,767) | (17,684,184) |
| ***Totali*** | **(19,143,767)** | **(17,684,184)** |

Shpenzimi amortizimit eshte llogaritur bazuar ne normat fiskale te amortizimit per cdo kategori aktivesh. Shoqeria e ka ndjekur kete politike per vite me radhe deri me 2020.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

## 28. Shpenzime te tjera operative

| Shpenzime te tjera shfrytezimi | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Trajtime te pergjithshme | (234,900) | (41,751,588) |
| Qera | (51,670,896) | - |
| Mirmbjatje dhe riparime | (7,424,733) | (8,093,199) |
| Sigurime | (2,746,924) | (2,556,941) |
| Te tjera | (20,932,455) | (19,599,795) |
| Personel jashte njesise | (17,745,165) | (17,360,114) |
| Pagesa te ndermjetesve dhe honorare | (24,892,606) | (12,551,346) |
| Shpenzime per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme | (17,704,741) | (15,671,070) |
| Publicitet, reklama | (37,527,052) | (31,640,506) |
| Transferime , udhetime, djeta | (4,960,108) | (13,733,515) |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | (3,039,134) | (3,029,636) |
| Shpenzime transporti per blerje | (982,514) | (687,846) |
| Sherbime bankare | (1,145,998) | (1,928,997) |
| Taksa tarifa doganore | (2,169,679) | (2,067,628) |
| Taksa dhe tarifa vendore | (1,066,945) | (1,425,900) |
| Sponsorizime, ndihma dhe fiancime te tjera te ngjashme | (1,548,954) | (2,508,028) |
| Shpenzime per pritje dhe perfaqsime | (3,111,027) | (5,660,710) |
| Gjoba, kamatvonesa dhe demshperblime | (1,382,917) | (3,291,459) |
| Shpenzime te tjera | (307,623) | (2,666,667) |
| ***Totali*** | **(200,594,371.32)** | **(186,224,943)** |

Shpenzimet e tjera operative perfshijne te gjitha sherbimet mbeshtetese dytesore per shoqerise si me siper perfshi kostot utilitare te telefonise, transportit te personelit, kostot bankare, gjobat e penalitete dhe shpenzime, si dhe demshperblime te tjera.

## 29. Te ardhura/ shpenzime te tjera financiare

| Te ardhura te tjera | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Fitim neto nga shitja e AAM dhe AAJM | 18,698 | 924,616 |
| Te ardhura nga rimarrja e provizioneve | 17,241,162 | - |
| Te ardhura te tjera | 654,424 | - |
| **Totali** | **17,914,283** | **924,616** |

## 30. Te ardhura / shpenzime financiare

Te ardhura dhe shpenzime financiare neto perbehen nga zerat si me poshte:

| Te ardhura / shpenzime financiare | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime interesa mbi huate | (30,189,472) | (30,780,572) |
| Fitim nga kembimet dhe perkthimet valutore | 1,354,072 | 4,398,590 |
| Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore | (5,177,633) | (1,450,069) |
| **Totali** | **(34,013,034)** | **(27,832,051)** |

Shpenzimet e tjera financiare perbehet nga interesate pagauar per overdraftet e marra per shoqerine. Pervec ketij zeri, jane dhe fitim / humbjet nga aktiviteti i shoqerise ne varesi te ecurise se kursit te monedhave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TRIMED
Sh.p.k.
Nipt: K51612031J
KOMPANI FARMACEUTIKE
1
TIRANË - ALBANIA

## 31. Tatim fitimi

Llogaritja e tatimit aktual per periudhen deri me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 perbehet si me poshte:

| Pershkrimi | 31 Dhjetor 2020 | 32 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| **Fitimi kontabel** | **111.239.158** | **98.589.122** |
| Minus te ardhurat per rimarrje provizioni ( te patatueshme) | (17.241.162) | - |
| **Fitimi para tatimit** | **93.997.996** | **98.589.122** |
| Shpenzime te pazbritshme | 44.267.087 | 35.055.343 |
| **Fitim tatimor per vitin** | **138.265.084** | **133.644.465** |
| Humbje tatimore te mbartura | - | - |
| **Fitimi tatimor i tatueshem** | **138.265.084** | **133.644.465** |
| Norma e tatim fitimit | 15% | 15% |
| **Total vlera per tatim mbi fitimin** | **20.739.763** | **20.046.670** |
| | | |
| **Fitimi neto** | **90.499.395** | **78.542.452** |
| | | |
| Te ardhura gjithe perfshirese ( Fitim humbje nga pjesemarrjet ) | (13.866.011) | 12.552.004 |
| | | |
| **Fitimi dhe te ardhurat gjithe perfshirese** | **76.633.384** | **91.094.456** |

Shpenzimet e pazbritshme per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2020 ne total paraqiten ne vleren 44 267 087 leke sipas tabeles qe vijon :

| Nr | Emertimi | Nr.llog. | 31 Dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| I | **Rezultati ushtrimor** | | **111,239,158** |
| | Minus -Rimarje te ardhura provizione te patatueshme | | 17,241,162 |
| II | **Rezultati ushtrimor para tatimit** | | **93,997,996** |
| III | **Shpenzime te panjohura** | | **44,267,087** |
| 1 | Shpenzime te panjohura | 618TM | 43,047 |
| 2 | Gjoba demshperblime | 61825TM | 55,350 |
| 3 | Shpenzime te pazbritshme | 618pzTM | 5,182,366 |
| 4 | Pagesa per gjoba kamatvonesa | 6232TM | 771,600 |
| 5 | Interesa financim ortaku | 628/456PZT | 7,174,613 |
| 6 | Pagesa kesh | 641.1TM | 234,900 |
| 7 | Gjoba demshperblime | 657TM | 1,382,917 |
| 8 | Shpenzime per provizione | 681.1TM | 29,422,295 |
| IV | **Fitimi fiskal para tatimit** | | **138,265,084** |
| 11 | Minus humbjen fiskale te mbartur | | **0** |
| V | **Fitimi i tatueshem** | | **138,265,084** |
| 12 | Tatim fitimi 15 % | | 20,739,763 |
| VI | **Fitimi neto fiskal** | | **117,525,321** |
| VII | **Fitimi neto tregtar** | | **90,499,395** |
| | Te ardhura gjithe perfshirese (Fitimi/humbje nga pjesmarrja) | | (13,866,011) |
| VIII | **Fitimi neto ushtrimor** | | **76,633,384** |

## 32. Transaksionet me palet e lidhura

Kuotat e shoqerise TRIMED shpk zoterohen 100% nga tre (3) Individe Ortake. Shoqeria nuk ka patur transaksione per shitjen ose blerjen e mallrave apo sherbimeve me ndonje kompani qe kualifikohet si pale e lidhur gjate vitit 2020 .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TRIMED
Sh.p.k.
Nipt K51612031J
1
KOMPANI FARMACEUTIKE
TIRANË - ALBANIA

## 33. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdorimi prej saj i instrumentave financiare:

- rreziku i kreditit,
- rreziku i likuiditetit,
- rreziku i tregut.

Ky shenim paraqet informacionin rreth ekspozimit te shoqerise ndaj secilit prej rreziqeve te mesiperme, objektivave te shoqerise, politikave dhe proçeseve per matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit te shoqerise. Shenime sasiore te tjera jane perfshire pergjate ketyre pasqyrave financiare.

Menaxhimi ka pergjegjesine e plote per hartimin dhe mbikeqyrjen e kuadrit te menaxhimit te rrezikut te shoqerise. Politikat e menaxhimit te rrezikut te shoqerise jane hartuar per te identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga shoqeria, per te vendosur limitet dhe kontrollet e duhura te rrezikut,dhe per te monituar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit te rrezikut rishikohen rregullisht per te reflektuar ndryshimet ne kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqerise. Shoqeria, nepermjet trajnimeve dhe standarteve e proçedurave te menaxhimit te saj, ka si qellim te zhvilloje nje mjedis te disiplinuar dhe konstruktiv te kontrollit ne te cilin te gjithe punonjesit jane ne dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentat kryesore financiare te shoqerise perbehen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, te arketueshmet, te pagueshmet, dhe te tjera te pagueshme.

### (a) Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditit eshte rreziku qe palet e lidhura me shoqerine te mos permbushin detyrimet qe rrjedhin nga marredhenie kontraktuale kundrejt investimit ne nje instrument financiar ose llogarie te arketueshme, duke e shtyre ate drejt humbjeve fianciare. Shoqeria eshte e ekspozuar ngaj rrezikut te kreditit nga aktivitetet qeraje dhe financuese, duke perfshire depozita e derivative me banka dhe institucione financiare.Rreziku i kreditit menaxhohet nga qeradhenesi duke kerkuar parapagime te kestit te qerase. Cilesia e kreditimit te qeradhenesit vleresohet ne baze te nje tabele gjithperfshirese pikesh ne momentin e hyrjes ne nje marredhenie qeraje.

Pjesa e mbetur duhet te monitorohet vazhdimisht. Me 31 dhjetor 2020, shoqeria eshte e ekspozuar ne menyre te konsiderueshme ndaj rreziqeve te kreditit. Me 31 dhjetor 2020 shoqeria ka llogari debitore, kryesisht me subjekte tregtare . Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit te rrezikut te kreditit. Maksimumi i ekspozimit te kreditit ne daten e raportimit paraqitet si me poshte:

| Pershkrimi | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Mjete monetare ne Banka | 35.492.580 | 18.748.996 |
| Te drejta te arketueshme, neto | 338.199.464 | 345.125.287 |
| Te drejta tatimore dhe te tjera | 48.847.697 | 11.904.944 |
| Parapagime | 1.979.068 | 1.745.220 |
| **Totali** | **424.518.809** | **377.524.447** |

### (b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe shoqeria do te hase veshtiresi ne permbushjen e detyrimeve te lidhura me detyrimet financiare te saj te cilat shlyhen me ane te mjeteve monetare apo te ndonje aktivi tjeter financiar.

Qellimi i shoqerise ne menaxhimin e likuiditetit eshte qe te siguroje, aq sa eshte e mundur, se ajo gjithmone do te kete likuiditetin e mjaftueshem per permbushjen e detyrimeve ne kohe, si ne kushtet normale ashtu edhe ne ato te veshtira, pa patur humbje te papranueshme apo pa rrezikuar demtimin e reputacionit te shoqerise. 30. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANE - ALBANIA

### (b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Me poshte paraqiten marredheniet kontraktuale, maturiteti i mbetur i aktiveve financiare dhe detyrimet duke perfshire pagesat e interesit deri me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

| ***31 dhjetor 2020*** | **Vlera e mbartur** | **< 3 muaj** | **3-6 muaj** | **6-12 muaj** | **1-10 vjet** |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive financiare*** | | | | | |
| Te drejta te arketueshme, neto | 338.199.464 | 174.238.124 | 89.280.160 | 45.340.620 | 29.340.560 |
| Te arketueshme te tjera | 48.847.697 | 21.826.842 | 21.350.620 | 5.670.235 | |
| Parapagime te dhena | 1.979.068 | 1.979.068 | | | |
| ***Detyrime financiare*** | | | | | |
| Huatë nga institucionet financiare | 129.319.445 | | | 129.319.445 | |
| Arketime ne avance per porosi | 30.690.573 | 30.690.573 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | 520.228.958 | 310.620.250 | 78.340.210 | 131.268.498 | |
| Detyrime ndaj ortakeve | 39.819.378 | 39.819.378 | | | |
| Detyrime tatimore | 12.331.038 | 12.331.038 | | | |
| Te tjera te pagueshme | 18.504.770 | 12.520.540 | 5.984.230 | | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | 416.755.879 | | | | 416.755.879 |
| **Pozicioni Neto** | **(778.623.812)** | **(207.937.745)** | **26.306.340** | **(209.577.088)** | **(387.415.319)** |

| ***31 dhjetor 2019*** | **Vlera e mbartur** | **< 3 muaj** | **3-6 muaj** | **6-12 muaj** | **1-10 vjet** |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive financiare*** | | | | | |
| Te drejta te arketueshme, neto | 345.125.287 | 197.083.753 | 109.828.819 | 33.509.929 | 4.702.785 |
| Te arketueshme te tjera | 11.904.944 | 11.904.944 | | | |
| Parapagime te dhena | 1.745.220 | 1.745.220 | | | |
| ***Detyrime financiare*** | | | | | |
| Huatë nga institucionet financiare | 60.451.081 | | | 60.451.081 | |
| Arketime ne avance per porosi | 31.287.236 | 31.287.236 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | 539.005.226 | 539.005.226 | | | |
| Detyrime ndaj ortakeve | 99.134.441 | 99.134.441 | | | |
| Detyrime tatimore | 12.834.790 | 12.834.790 | | | |
| Te tjera te pagueshme | 13.548.839 | 13.548.839 | | | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | 416.755.879 | | | | 416.755.879 |
| **Pozicioni Neto** | **(814.242.041)** | **(485.076.615)** | **109.828.819** | **(26.941.152)** | **(412.053.094)** |

## 34. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

**Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### (a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku i ndryshimit te cmimit te tregut, te tille si normat e interesit, normat e kursit te kembimit dhe cmimet e kapitalit qe do te ndikojne ne te ardhurat e shoqerise ose vleren e instrumentave financiare te zoteruara prej saj. Objektivi i menaxhimit te rrezikut te tregut eshte te menaxhoje dhe kontrolloje ekspozimin ndaj rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshme ndersa optimizohet e ardhura.

Rreziku i tregut perbehet nga rreziku i normes se intersit, rreziku i kursit te kembimit, rreziku i tregut dhe ndryshimi ne cmimet e kapitalit.

Shoqeria kontrollon risqet duke mbajtur edhe nje nivel te caktuar borxhi te percaktuar ne me pak se 60% kundrejt totalit te detyrimeve dhe kapitalit.

Marreveshjet e qerase perfshijne nje klauzole e cila lejon rregullimin e pagesave te qerase ne perputhje me kushtet e tregut per te menaxhuar rrezikun e cmimeve te tregut.

*Rreziku i kurseve te kembimit*

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit lidhur me luhatje te mundshme ne normat e kembimit persa i perket transaksioneve te saj ne monedhe te huaj. Shoqeria ka teprica te konsiderueshme ne Euro kundrejt furnitoreve dhe qeramarresve, te cilat e ekspozojne njesine kundrejt rrezikut te monedhes se huaj.

### (c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Kursi i kembimit gjate viteve paraqitet si me poshte:

| Monedha | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| EUR/LEK | 121.77 | 121.77 | 123.42 |
| USD/ LEK | 108.64 | 108.64 | 107.10 |

*Analiza e ndjeshmerise*

Ne menaxhimin e rrezikut te kursit te kembimit shoqeria ka per qellim te zvogeloje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitimet e shoqerise. Megjithate, ne periudha afatgjate, ndryshimet e perhershme ne normat e kurseve te kembimit mund te kene ndikim ne fitim. .

**Analiza e ndjeshmerise ndaj kurseve te kembimit**

Analiza e ndjeshmerise eshte percaktuar bazuar ne ekspozimin ndaj normave te kembimit ne daten e raportimit dhe ndryshimeve specifike ne fillim te vitit kontabel dhe qe mbarten gjate gjithe periudhes kontabel.

## 35. Raportimi i vleres se drejte

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare percaktohet si vlera ne te cilin instrumenti mund te shkembehet lehtesisht midis paleve te rena dakort ne nje transaksion, ne diten e matjes duke iu referuar kushteve aktuale te tregut (cmimi i shitjes ne diten e matjes nga perspektiva e pales qe zoteron aktivin apo qe mbart detyrimin). Kur nje cmim nuk eshte i identifikueshem ne treg, Shoqeria mat vleren e drejte duke perdorur teknika vleresimi qe maksimizojne perdorimin e te dhenave te tjera te identifikueshme ne treg dhe minimizojne te dhenat e paidentifikueshme.

## 36. Detyrime te kushtezuara

*Çeshtjet gjyqesore*

Gjate vitit 2020 Shoqëria nuk ka asnje çeshtje gjyqesore si padites ose i paditur, me punonjës të larguar dhe subjekte te tjera tregtare për vlera te ndryshme, te konfirmuara nga departamenti Ligjor.

## 37. Ngjarjet pas dates se bilancit

Ngjarje e vetme pas dates se bilancit eshte ngjarja e pandemise Covid -19 e cila gjate vitit 2020 ka dhënë një goditje të fortë biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi.

Drejtimi i shoqerise nuk eshte ne dijeni te ngjarjeve qe ndodhin pas dates se bilancit dhe qe kerkojne rregullime ose shtesa ne shenimet shoqeruese te pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, meqenëse drejtuesit e shoqerise besojnë se shoqeria do të vijojë të paktën aktivitetet e saj administrative edhe gjatë vitit pasardhës.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TRIMED Sh.p.k. Nipt K51612031J 1 KOMPANI FARMACEUTIKE TIRANË - ALBANIA